

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	31.05.2021	Kërkesë për informbi mënyrën e rinovimit të kartës së shëndetit	01.06.2021	Përsëndetje, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkon shërbimin “Aplikim për kartë shëndeti” dhe përzgjidhni rubrikën “Përdor”. Më pas kliko tek "Për të rinovuar afatin e vlefshmërisë". Gjithashtu zgjidhni dhe kategorinë që me sa kuptova jeni i "Vet punësuar" dhe në fund "Apliko". Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx . Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit.Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka
2	01.06.2021	Kërkesë për info për deklarimet personale	01.06.2021	Përsëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti	E deleguar	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

				publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Sa më sipër gjeni mëposhtë kërkesën e qytetares, në lidhje me deklaratimet.Lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit!		
3	01.06.2021	Kërkesë për procedurën dhe dokumentacionin e përfitimit të bonusit kur fëmija ka lind jashtë	01.06.2021	Përsëndetje ,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije dy mënyrat e regjistrimit të fëmijëve të lindur jashtë shteti si dhe tërheqjen e bonusit si më poshtë vijon : Rasti 1 . Fëmija regjistrohet nga një person i tretë Në pamundësi të paraqitjes së prindërve pranë zyrave të Gjendjes Civile të Njësisë suaj Administrative për të bërë regjistrimin e fëmijës së lindur jashtë shtetit, në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri dhe rrjedhimisht edhe në certifikatën tuaj familjare, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta: · Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve; · Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar. Duhet theksuar në Prokurën e Posaçme që personi autorizohet të bëjë regjistrimin e fëmijës, dhe të kryejë tërheqjen e çekut të bebes gjithashtu.Në vijim prindi, ose personi i autorizuar, pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile pajis prindërit me 2 (dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë famjiljare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin “Për bonusin e lindjes”,sëbashku me prokurën duhet të paraqiteni pranë Shërbimit Social Shtetëror.Prokura e posaçme lëshohet nga nëna e fëmijës, pasi edhe çeku emetohet nga Shërbimi Social Shtetëror në emër të nënës.Tërheqja e çekut bëhet pranë Shërbimit Social Shtetëror në Tiranë me adresë: Rruga e Durrësit, Nr.83. Rasti 2 . Fëmija regjistrohet nga prindërit Njëri nga prindërit e fëmijës paraqitet pranë gjendjes civile me dokumentat e mëposhtme: · Akti I lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë	E plotë	Nuk ka

				legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar · Kopje të letërnjoftimeve elektronike të dy prindërve Pas regjistrimit të fëmijes në gjendjen civile nëpunesi lëshon Certifikatë famjiljare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin “Për bonusin e lindjes” sëbashku me fotokopjen e dokumentave të identifikimit duhet të paraqiteni pranë Sherbimit Social Shtetëror në Tiranë për të bërë tërheqjen e cekut.Në rast se deklarimi i aktit të lindjes të mbajtur jashtë vendit kryhet jashtë afatit 90- ditor, nëpunësi i gjendjes civile e pajis deklaruesin me certifikatën personale e familjare me shënimin “Lindje jashtë shtetit, nr..akti, datë..., vendin ku ka ndodhur lindja, “Për përfitim të ndihmës së menjëhershme financiare Bonus, regjistruar jashtë afatit 90-ditor, nuk përfiton çekun prej 5 000 pesë mijë lekësh). Për cdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
4	01.06.2021	Kërkesë për info për procedurën e aplikimit për vërtetim kontributesh	01.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkon shërbimin ““Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore (para datës 01.01.1994) ”” dhe përzgjidhni rubrikën “Përdor”.Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx.Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t’i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit.Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka
5	02.06.2021	Kërkesë për info mbi bonusin e fëmijës së lindur në spital privat	02.06.2021	Përhëndetje e nderuar,Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se pas regjistrimit, prindi pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit.Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përftimin e bonusit,	E plotë	Nuk ka

				nëpunësi i gjendjes civile ju pajis me 2 (Dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë familjare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin “Për bonusin e lindjes”. Personi i autorizuar (i pajisur me prokurë të posacme) duhet të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e 2 (dy) certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfitim të çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar. Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
6	01.06.2021	Kërkesë për informbi procesin e legalizimit	02.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se Ju mund t’i drejtoheni sporteleve fizike të ADISA.Sportelet i gjeni: - ADISA, Njësia Administrative numër 6, Kombinat. - ADISA, Rruga "Panorama", (ish - hipoteka e Tiranës) Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
7	01.06.2021	Kërkesë për informbi aplikimin në eAlbania për njësim titulli doktrature	02.06.2021	Përhëndetje znj. Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkon shërbimin “Njësimi i diplomave dhe certifikatave të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë” dhe përzgjidhni rubrikën “Përdor”. Më pas zgjidh "Aplikim i ri" dhe do ju shfaqet formulari i aplikimit. 1. Në bazë të udhëzimit nr. 17, datë 3.8.2016, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, të ndryshuar pagesa për njësimin e gradave shkencore është 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë. 2. Përsa i përket dokumentave që ju duhe të dorëzoni, ju duhet ti referoheni udhëzimit nr. 30, datë 30.12.2019, “Për disa shtesa	E plotë	Nuk ka

				dhe ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 3.8.2016 "Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit", të cilin po jua a bashkangjis.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
8	01.06.2021	Kerkesë për info për lidhje martese në shtetin Grek	02.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se nuk kemi informacion mbi procedurat që ndjek për lidhje martese shteti Grek. Ju mund ta lidhni martesën me bashkëshorten në shtetin Shqiptar.Për sa i takon regjistrimit të fëmijës, ju mund ta regjistroni në Gjendjen Civile edhe pa kryer celebrimin. Mund ta regjistroj bashkëshortja juaj dhe t'i jepni atësinë.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
9	02.06.2021	Kërkesë për info mbi procedurën e regjistrimit të një prone të ndërtuara para 1991	02.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Si fillim duhet të paraqiteni pranë Njesisë Administrative në Kukës për të kontrolluar në e ka në listën e trojeve pronën në emër të babait, nëse po së bashku me Dëshminë e Trashëgimisë, Njësia e përcjell në ASHK për regjistrim. Nëse nuk dispononi një titull pronësie hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin “ Kërkesë për kalimin e pronësisë të objektit pa titull/truallit funksional/oborrit në përdorim” dhe përzgjidhni rubrikën “Përdor”. Dokumentacioni i nevojshëm është: Certifikatë familjare e vitit 1991; 4 foto të objektit; Plan rilevimi Kartë Identiteti Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx .	E plotë	Nuk ka

				Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit. Gjithë të mirat!		
10	02.06.2021	Kërkesë për informbi mënyrën e aplikimit të kërkesës për pajisje me leje legalizimi	02.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë: Ju mund të aplikoni në eAlbania edhe nga jashtë Shqipërisë. Nr për komunikim kemi vetëm call center. Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin “Kërkesë për legalizim të ndërtimit pa leje” ose aksesoni linkun e mëposhtëm https://ealbania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14542 dhe përzgjidhni rubrikën “Përdor”. Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx . Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t'i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit. Gjithë të mirat!	E plotë	Nuk ka
11	02.06.2021	Ankesë për moshkalimin e të ardhurave të barrëlindjes.	03.06.2021	Përhëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e znj., kërkoni të informohet për kalimin e të ardhurave të barrëlindjes. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të qytetares. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
12	02.06.2021	Kërkesë për informbi mënyrën e kryerjes së deklaratës së të ardhurave	03.06.2021	Përhëndetje e nderuar, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se për shërbimin e kërkuar ju mund të aplikoni në faqen e Tatimeve, eFiling. Nëse jeni një individ privat dhe doni të dorëzoni Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave për Individët dhe jeni të regjistruar në eFiling, klikoni këtu: https://efiling.tatime.gov.al/cats_public/Account/LogOn Nëse jeni një individ privat dhe doni të dorëzoni Deklaratën Individuale	E plotë	Nuk ka

				Vjetore të të Ardhurave për Individet, por nuk jeni të regjistruar në eFiling, ju mund të regjistroheni duke klikuar këtu. https://efiling.tatime.gov.al/cats_public/UserManagement/Registration Për informacion më të zgjeruar, Ju udhëzojmë t'i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të marrë informacionin e kërkuar, sipas kontakteve të mëposhtme: Telefon: 04 22 76 840 Postat elektronike: e-tatime@tatime.gov.al Për më shumë asistencë mund të drejtoheni pranë qendrës së Shërbimit Tatimpagues, në DRT e vendbanimit tuaj. Faleminderit!		
13	03.06.2021	Kërkesë për informbi dokumentat për lidhje martese	07.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju bëjmë me dije se procedura për të bërë shpalljen e martesës është si mëposhtë vijon: Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: · Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile; · Dokumentin/certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); · Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; · Fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: · Certifikatë lindje; · Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës	E plotë	Nuk ka

				dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesë. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martesë /ekstrakt akt martesë) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Ju informojmë se shpallja e martesës mund të bëhet edhe me prokurë, por për celebrimin duhet të jetë i pranishëm. Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
14	03.06.2021	Kërkesë për info për rikuperimin e të dhënave të llogarisë personale në eAlbania	07.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal duhet të dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Gjithashtu, Ju mund të paraqiteni pranë sporteleve ADISA për asistencë për rikuperimin e llogarisë. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 16:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
15	03.06.2021	Kërkesë për info mbi procedurën e aplikimit për pasaportë nga jashtë kufijëve	07.06.2021	Përhëndetje i nderuar, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se përsa i përket shërbimit " Aplikim për pasaportë biometrike" ju mund të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania. Më pas për zgjidhni rubrikën "Aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti (për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve)" Referuar	E plotë	Nuk ka

				vendimeve të fundit të Policisë së Shtetit Ju informojmë se: Për të kryer aplikimin për pajisje të Pasaportës Biometrike për herë të parë sic është rasti juaj, ju nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar: https://ealbania.al/eAlbaniaServices/DPPSH/13882/DPPSH_13882_n3_s1_ëeb.aspx?service_code=13882 Pas shqyrtimit të aplikimit, ju do të njoftoheni brenda 1 dite për aplikim me procedurë të përsheptuar dhe brenda 7 ditësh për aplikim normal nga Policia e Shtetit, dhe më pas duhet të vijoni me rezervimin e takimit prane zyrave të ALEAT.Për të rezervuar takimin ju duhet të bëni rezervimin në adresën: https://rezervo.aleat.al/Klikoni linkun dhe plotësoni të dhënat e kërkuara tek plotësimi i nr ID për fëmijën ju rikujtojmë që mund ta gjeni tek certifikata e lindjes 1. Zgjidh datën dhe orarin 2. Në fund zgjidh rezerv Mos harroni të çekoni opsionin Kushtet e përdorimit.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 16:00.Faleminderit!		
16	03.06.2021	Kërkesë për informbi procedurën e anulimit të martesës	07.06.2021	Përhëndetje i nderuar,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të Znj., e cila kërkon të informohet mbi procedurat që duhet të ndjekë për të përket anulimit të shpalljes së martesës.S’a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
17	04.06.2021	Kërkesë për informbi vlefshmërinë e pasaportës së	07.06.2021	Përhëndetje znj.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik,	E deleguar	Nuk ka

		vaksinës për jashtë vendit, për të huajt rezident në Shqipëri		brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Mëposhtë gjeni kërkesën e Z., i cili kërkon të informohet mbi vlefshmërinë e pasaportës së vaksinimit për udhëtimet jashtë Shqipërisë.Sa më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!		
18	04.06.2021	Kërkesë për info mbi dokumentacionin për lidhje martese	07.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj, do te gjeni më poshtë një informacion të përmbledhur mbi procedurën e shpalljes së martesës.Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të Dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin.Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”;fotokopje e dokumentit të identifikimit;Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit.Nëse martesa do të lidhet në një shtet të huaj, pas kalimit të afatit 10 ditor nga shpallja e martesës, duhet të pajisen me këto dokumente:certifikatë lindje;certifikatë lindje, me shënim “për lidhje martese”;Këto dokumente duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të ndjekur më pas procedurën e lidhjes së martesës sipas legjislacionit të vendit të huaj ku bashkëshortët e ardhshëm kanë vendqëndrimin. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare.Për cdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
19	04.06.2021	Kërkesë për info për certifikatë familjare në gjuhë	07.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj, ju bëjmë me dije se me certifikatë në gjuhë të huaj mund të pajiseni vetëm pranë sporteve të Gjendjes Civile ku ju keni regjistrimin.Nëse ky	E plotë	Nuk ka

		të huaj		dokument do të përdoret jashtë vendit duhet të legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
20	04.06.2021	Kërkesë për informim disa verifikime për deklarimin e të ardhurave personale	07.06.2021	Përsëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Sa më sipër gjeni mëposhtë kërkesën e qytetares, në lidhje me disa verifikime për kryerjen e deklarimit të të ardhurave personale.Lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
21	05.06.2021	Kërkesë e paqartë	07.06.2021	Përsëndetje,Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n'a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë. Ku e keni kryer regjistrimin? Me regjistrim e keni fjalën në regjistrin e Gjendjes Civile?Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E refuzuar	Nuk ka
22	05.06.2021	Kërkesë për informim procedurat që duhen ndjekur për marrjen e mbiemrit të bashkëshortit pas lidhjes së martesës	07.06.2021	Përsëndetje i nderuar,Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme ku qytetari kërkon informohet mbi procedurat që duhet të ndjekë për marrjen e mbiemrit të bashkëshortit pas lidhjes së martesës.S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
23	05.06.2021	Kërkesë e	07.06.2021	Përsëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj, Ju informojmë se ADISA	E refuzuar	Nuk ka

		pasaktë		është institucion shtetëror dhe ka si qëllim krijimin dhe transformimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike në Shqipëri, përmes qasjes me qytetarin dhe përmirësimin e shërbimeve me natyrë administrative për qytetarin dhe biznesin. Gjithashtu, misioni i saj është të ofrojë shërbime publike nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të sporteve pritëse për qytetarët (front office) si dhe qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë (one-stop-shop), duke ofruar shërbimet e disa institucioneve, të renditura dhe të përzgjedhura në bazë të kërkesave të qytetarëve, në një vend të vetëm. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
24	06.06.2021	Kërkesë për info për mënyrën e kryerjes së pagesës së deklartimit të të ardhurave personale	07.06.2021	Përsëritet znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Sa më sipër gjeni mëposhtë kërkesën e z. në lidhje me mënyrën e kryerjes së pagesës së deklartimit të të ardhurave personale.Lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
25	06.06.2021	Kërkesë për info nëse Diploma e Masterit që disponon përmbush kushtet për marrjen e licencës	07.06.2021	Përsëritet, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën, ku qytetari kërkon të informohet nëse Diploma e Masterit që disponon përmbush kushtet për marrjen e licencës.Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tonë zyrtare.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
26	06.06.2021	Kërkesë për info për rikuperimin	07.06.2021	Përsëritet,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni	E plotë	Nuk ka

		e të dhënave të llogarisë personale në eAlbania		rregjistruar në portal duhet të dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e nënës Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Gjithashtu, Ju mund të paraqiteni pranë sporteleve ADISA për asistencë për rikuperimin e llogarisë. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 16:00. Faleminderit!		
27	06.06.2021	Kërkesë për informbi afatet e fillimit të aplikimeve për formularin A1Z dhe sa zgjat afati për këtë vit akademik	07.06.2021	Përhëndetje z.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Mëposhtë gjeni kërkesën e Znj., e cila kërkon të informohet mbi afatet e fillimit të aplikimeve për formularin A1Z dhe sa zgjat afati për këtë vit akademik. Sa më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit	E deleguar	Nuk ka
28	06.06.2021	Kërkesë e paqartë	07.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n'a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë. Ju e keni kryer regjistrimin në gjendjen Civile? Jeni pajisur me dokumentat pas regjistrimit? Po procedurën për marrjen e cekut pranë Drejtorisë së Shërbimit Social i keni kryer? Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E refuzuar	Nuk ka
29	07.06.2021	Kërkesë për informi regjistrimin e fëmijës	07.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se është detyrim ligjor regjistrimi i fëmijës Tuaj dhe kryhet para punonjësit të Zyrës së Gjendjes Civile ku jeni regjistruar. Ky regjistrim nuk mund të bëhet nëpërmjet portalit e-albania por mund ta kryhet nga	E plotë	Nuk ka

				një i afërmi juaj pranë Zyrrave të Gjendjes Civile nëse nuk jeni në Shqipëri. Për të kryer regjistrimin e fëmijës në regjistrin kombëtar të popullsisë në Shqipëri, duhet të dërgoni pranë familjarëve tuaj këto dokumenta: Prokurë e Posaçme për personin që do të kryejë regjistrimin dhe kopje të letërnjoftimeve elektronike të Dy prindërve; Aktin e lindjes të mbajtur jashtë shtetit, i cili duhet të jetë legalizuar me vulë Apostile dhe i përkthyer në gjuhë n shqipe dhe i noterizuar. Në përfundim të regjistrimit të të porsalindurit, me qëllim përfitim e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile ju pajis me 2 (Dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë familjare dhe Certifikatë lindje e të porsalindurit, më shënimin “Për bonusin e lindjes”. Në vijim, prindi pajiset me Regjistrimin e aktit të lindjes, Certifikatën e aktit të lindjes, Certifikatën familjare dhe Certifikatën personale të të porsalindurit. Tërheqja e çekut (bonusi) bëhet personalisht nga prindi/prindërit dhe afati është 1 vit kalendarik nga dita e lindjes së foshnjës. Në rast se ju nuk mund të jeni të pranishëm, me një Prokurë të Posaçme mund të autorizoni një të afërm të bëjë regjistrimin e fëmijës, si edhe të kryejë edhe tërheqjen e çekut të bebes. Personi i autorizuar (i pajisur me prokurë të posaçme) duhet të paraqitet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror në Sektorin e financës, me qëllim dorëzimin e Dy certifikatave (familjare dhe lindje e fëmijës) dhe përfitim e çekut të bonusit të lindjes, sipas masës së përcaktuar. Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
30	07.06.2021	Kërkesë për info për marrje license për herë të parë për prodhimin e Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme	07.06.2021	Përsëritet, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, lutem gjeni mëposhtë kërkesën, ku qytetari kërkon të informohet për marrje license për herë të parë për prodhimin e Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme pasi	E deleguar	Nuk ka

		pasi zotëron diplomë të Nivelit Master i Shkencave “Energjitë e Rinovueshme.		zotëron diplomë të Nivelit Master i Shkencave “Energjitë e Rinovueshme.Gjithashtu bashkëlidhur dhe emaili drejtuar në adresën tonë zyrtare.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z.Faleminderit!		
31	07.06.2021	Dërgim i faturës së shlyerjes së detyrimeve tatimore	08.06.2021	Përhëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Sa më sipër gjeni mëposhtë përgjigjen e qytetarit, i cili pretendon që i ka paguar detyrimet. Bashkëlidhur statment e Bankës.Lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
32	07.06.2021	Kërkesë për info për mënyrën për pajisjen me vërtetim pozitiv/negativ	08.06.2021	Përhëndetje,Në vijim të pyetjes Tuaj, ju bëj me dije se vërtetimi pozitiv/negativ tregon gjëndjen aktuale të pronave dhe nuk është e nevojshme të cilësohet viti. Duhet të keni parasysh që ju duhet të aplikoni për secili antar të familjes nëpërmjet eAlbania. Që dokumenti të ketë vlerë për jashtë vendit pasi tju vijë ky i fundit në llogaritë tuaj personale duhet të ndiqni hapat e mëposhtë:Dokumenti duhet të legalizohen pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me adresë: Rruga Dora D’IstriaTiranë 1. Dokumentin e përkthe dhe noterizon 2. Më pas duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme 3. Aplikimet për legalizim kryhet në zyrat e Postës Shqiptare. Për cdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
33	07.06.2021	Kërkesë për rikuperim passëordi në llogarinë	08.06.2021	Përhëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek numri i telefonit dhe tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal, per te rikuperuar llogarine Tuaj ne e-albania, duhet të dërgoni këto të dhëna në	E plotë	Nuk ka

		eAlbania		adresën helpdesk@e-albania.al : - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - datëlindja e vendlindja e nënës Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.Gjithashtu, Ju mund të paraqiteni pranë sporteleve ADISA për asistencë për rikuperimin e llogarisë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
34	07.06.2021	Kërkesë për info për procedurat për hapje biznesi	08.06.2021	Përhëndetje e nderuar,Në vijim të kërkesës suaj, Ju bëjmë me dije si më poshtë:Portali e-Albania ju mundëson që shërbimin për regjistrim fillestar të një sipërmarrjeje ta bëni përmes internetit, duke zgjedhur këtë lidhje elektronike: https://ealbania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspxservice_filter=INS&institution_id=48&institution_name=Qendra%20Komb%c3%abtare%20e%20Biznesit%20(QKB)&service_type=Y. Më pas mund të përzgjidhni shërbimin e volitshëm për ju sipas formës juridike që dëshironi të hapni, konkretisht me emërtimin: “Aplikim për regjistrim fillestar të...” (person fizik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, etj.).Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje:https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx. Përsa i takon ambjentit ku do të ushtrohet aktiviteti edhe pse është në pronësi të familjarëve është e nevojshme kontrata e përdorimit ose qiras, kjo mbetet në zgjedhjen tuaj.Për cdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
35	07.06.2021	Kërkesë për info mbi procedurë që duhet të ndjekë përsa i	08.06.2021	Përhëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda	E deleguar	Nuk ka

		përket kasës për monitorimin e raporteve financiare të xhiros ditore/mujore/vjetore, në bazë të ligjit të ri		afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.Sa më sipër gjeni mëposhtë pyetjen e z.Roko, e cila kërkon të informohet mbi procedurë që duhet të ndjekë përsa i përket kasës për monitorimin e raporteve financiare të xhiros ditore/mujore/vjetore, në bazë të ligjit të ri? Lutemi për një përgjigje nga ana juajFaleminderit!		
36	08.06.2021	Kërkesë për info mbi procedurën e aplikimit për regjistrimin e lejes së legalizimit	08.06.2021	Përsëritje,Në vijim do të gjeni hapat e nevojshme që duhen ndjekur për të marrë shërbimin e kërkuar: 1. Për të regjistruar lejen e legalizimit dhe për t'u pajisur me dokumentin e pronësie, Ju duhet të keni një llogari në portalin e - albania; 2. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkon shërbimin “Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ” 3. Pasi të klikoni opsionin "Përdor" , Ju do të keni mundësi që në faqen e shfaqur të vendosni të dhënat personale dhe të pasurisë sipas fushave përkatëse; KUJDES: pasi të keni plotësuar të dhënat personale dhe ato të pasurisë, në hapin e radhës do t'ju shfaqet shërbimi i kërkuar "Aplikim për regjistrimin e kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës, apo të një akti administrativ " i cili lidhet me kodin e shërbimit ASHK_R2. Në këtë faqe ju jepet mundësia të shtoni kode të tjera shërbimi të cilat duhen vendosur në mënyrë që aplikimi të quhet i plotë. Shërbimet që duhen shtuar janë; - L1 (Lëshim çertifikate pronësie) - I4 (Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale) - I5 (Lëshim kopje kartelet të pasurisë) Pasi të kryeni aplikimin, Ju duhet të dorëzoni nëpërmjet shërbimit postar dokumentat origjinale. Përgjigjen do të mund ta merrni me vulë dhe firmë elektronike duke klikuar "Dokumentat e Mia" në profilin Tuaj në e-Albania. Nëse keni vështirsi të aplikoni nëpërmjet portalit, Ju mund t'i drejtoheni sporteve fizike te ADISA.Sportelet i gjeni:	E plotë	Nuk ka

				- ADISA, Njësia Administrative numër 6, Kombinat. - ADISA, Rruga "Panorama", (ish - hipoteka e Tiranës) Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
37	08.06.2021	Kërkesë për informimbi periudhën e sigurimit për përfitimin e të ardhurave të barrëlindjes	08.06.2021	Përsëritet e nderuar,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se përsa i përket pyetjes tuaj, Ju bëjmë me dije se në nenin 27 dhe 29, të ligjit nr. 7703, datë11.05.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar është percaktuar si ne vijim: Neni 27 E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi në total (këtu përfshihen të gjitha punët e kryera në vite), deri në momentin që i lind e drejta për përfitim të paralindjes, dhe nga këto 12 muaj të paktën një muaj sigurim ta ketë gjatë shtatëzansës. Neni 29 Shpërblim për lindje fëmije i paguhet një personi të siguruar, i cili është nëna ose babai i një fëmijë që lind, me kusht që njëri prej tyre të ketë kontribuar 12 muaj në total para lindjes së fëmijës. Shpërblimi do të bëhet i pagueshëm vetëm një herë dhe nëna do të ketë përparësi në përfitimin e pagesës, në rast se ajo është e siguruar; 2. Shpërblimi për çdo fëmijë të lindur do të jetë një shumë e barabartë me 50 përqind të pagesës minimale mujore. Sa me sipër, nëse Ju, deri në momentin do t'ju lindi e drejta për të përfituar paralindjen (35 ditë para ditës së lindjes) do të keni në total 12 muaj periudhë sigurimi (këtu përfshihen të gjitha periudhat e sigurimit që keni realizuar nga punët e kryera nëpër vite) dhe të ketë të paktën 1 muaj sigurim do e keni gjatë shtatëzansës, do të përfitoni shpërblimin e lindjes dhe të ardhurat nga barrëlindja.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka

38	08.06.2021	Kërkesë për informacion dhe procedurën e lidhjes së martesës	09.06.2021	Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se në fillim duhet të bëni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptarë në Republikën e Shqipërisë është si mëposhtë vijon :Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e dokumentit të identifikimit; Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martese. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë.Pra , shpallja e martesës do kryhet në gjendjen Tuaj civile dhe në Fierze ku ka vendbanimin bashkeshortja Juaj e ardhshme.Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
39	08.06.2021	Kërkesë për informacion për ndryshim vendbanimi	09.06.2021	Përsëritet, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se për të ndryshuar vendbanimin duhet të shkoni pranë gjendjes civile ku dëshironi të keni vendbanimin e ri për të bërë aplikimin për këtë shërbim.Dokumentacioni i nevojshëm për të kryer shpërnguljen është si më poshtë vijon : 1. Fotokopje e letërnjoftimit (karta e identitetit) 2. Kontratën apo çdo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që i jep shtetasit të drejtën e përdorimit të banesës ose; 3. Dokumentin e pronësisë së banesës ose kontratë	E plotë	Nuk ka

